

Klementina Çela

Mban pozicionin e Avokatit të Shtetit pranë Zyrës së Këshillimit dhe Koordinimit Ndërministror në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit.

Është diplomuar me titullin “*jurist*” (Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë), në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 2011.

Në periudhën shtator 2013 - korrik 2014 ka përfunduar studimet, “*Master Profesional European Business Law*”, në po të njëjtin Universitet.

Në vitin 2014, ka marrë titullin “*Avokat*” nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Znj. Çela ka eksperiencë pune në sektorin privat si dhe në administratën gjyqësore. Fillimi i ushtrimit të profesionit ka qenë në sektorin privat e më tej ka ushtruar detyrën e Sekretares Gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Prej korrikut të vitit 2018, është pjesë e stafit të Avokaturës së Shtetit, duke mbajtur pozicionin e Avokates së Shtetit pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në vitin 2019 ka marrë titullin “*Avokat Shteti*” dhe është emëruar si Avokate Shteti pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Në karrierën e saj profesionale ka kryer një sërë trajnimesh pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe pranë organizatave të ndryshme vendase dhe të huaja, kryesisht në fushat civile, administrative dhe tregtare.

Zotëron njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, frënge dhe italiane.